



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 96

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 28 qershor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10817, datë 25.6.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6095
Dekret i Presidentit nr. 10818, datë 25.6.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6095
Dekret i Presidentit nr. 10819, datë 25.6.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6095
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 21, datë 22.6.2018	Për disa shtesa në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistrimi”..... 6096
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 39, datë 1.6.2018	Për licencimin e sh.a. Ujës-jellës-Kanalizime Konispol..... 6098
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 40, datë 1.6.2018	Për licencimin e sh.a. Ujës-jellës-Kanalizime Tropojë..... 6098
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 41, datë 1.6.2018	Për licencimin e Ujës-jellës-Kanalizime sh.a. Finiq..... 6099

Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 42, datë 13.6.2018	Për marrjen e masave administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a.....	6100
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 43, datë 13.6.2018	Për marrjen e masës administrative ndaj shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë sh.a.....	6101
Kërkesë e Ministrisë së Brendshme nr. 1690/5, datë 25.6.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i sheshit te lagja ‘Lugina’”, Bashkia Shijak.....	6101
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9145/1, datë 26.6.2018	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”.....	6103
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 9148/1, datë 26.6.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Devoll’”.....	6105

**DEKRET****Nr. 10817, datë 25.6.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme dhe ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Kemajl Sabit Gashi
2. Igballe Hazir Bunjaku (Beqiri)
3. Donika Binak Kadaj Bujupi (Kadaj)
4. Naser Halil Bujupi
5. Edison Sejdi Ukimeraj
6. Anilë Xhevdet Sylaj Zhugolli (Sylaj)
7. Alma Selajdin Limani
8. Daut Hilmi Haradinaj
9. Flora Mustafë Haradinaj (Muçaj)
10. Gani Mustafa Dreshaj
11. Besa Murat Dreshaj (Alihajdaraj)
12. Ahmet Limon Isufi
13. Shukrije Hajrullah Bajrami
14. Dardan Xhelal Ademi
15. Visar Abit Kahirmani
16. Osama Fathi Jararaa
17. Ferdinando Cosimo Iurlo
18. Valentina Pala Doda
19. Aslan Mecit Başak
20. Ramazan Mustafa Alkaç
21. Fatma Mümin Fidan (Özkul)
22. Ahmed Yarob Rayyan
23. Mehmet Fevzi Ertaş
24. Fitim Avdyl Krasniqi
25. Dafina Fehmi Krasniqi (Avdyli)
26. Granit Mustafa Krasniqi
27. Carloalberto Claudio Rossi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10818, datë 25.6.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Jakup Januz Krasniqi
2. Sevdije Sadri Krasniqi (Shala)
3. Çlirimtare Jakup Krasniqi
4. Gresa Jakup Krasniqi
5. Altin Jakup Krasniqi
6. Hasan Mikdat Okur
7. Tevfik Fikret Seydi Oktay
8. Dervish Isa Qerreti
9. Olha Mykola Bici (Klymuk/Tkach)
10. Mohamed Saber Mohamed Saber
11. Mostafa Belal Abdelhakim Elshehaby
12. Yunus Ramazan Aslan
13. Dilek Tahsin Ince (Mertoğlu)
14. Serkan Muzaffere Keleş
15. Naile Abdurrahman Keleş (Özdemir)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

DEKRET**Nr. 10819, datë 25.6.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë së Brendshme,



DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Fatmir Nexhmi Sejdiu
2. Nezafete Abdullah Sejdiu (Hoxha)
3. Bardhyl Fatmir Sejdiu
4. Rudina Agron Kamberi
5. Visar Naser Hoxha
6. Emir Şuayip Coşkun
7. Serkan Abdullah Ateş
8. Afrim Imri Saramati
9. Giovanni Severino Maurizi
10. Mona Ismail Rayyan
11. Mohammad Yarob Rayyan
12. Enas Yarob Rayyan
13. Mentor Hasan Dulaj
14. Elvane Lytfi Çollaku (Bytyqi/Bytyçi)
15. Luz Kolë Nikollbibaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM

Nr. 21, datë 22.6.2018

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.
31, DATË 26.12.2013, “PËR EMETIMIN
NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, TË OBLIGACIONEVE NË
FORMË REGJISTRIMI”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 31, datë 26.12.2013, “Për emetimin nga qeveria e Republikës së Shqipërisë të obligacioneve në formë regjistrimi”, bëhen disa shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1 pas fjalëve “në formë regjistrimi” shtohen fjalët “dhe të obligacioneve referencë (*benchmark*) ...”.

Neni 2

Pas nenit 1, shtohet neni 1/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 1/1

Përkufizime

1. Obligacionet në formë regjistrimi janë titujt shtetërorë me afat maturimi më të madh se një vit, të cilat emetohen dhe garantohen nga qeveria e Republikës së Shqipërisë.

2. Obligacionet referencë (*benchmark*) janë obligacionet në formë regjistrimi, të përzgjedhur të Republikës së Shqipërisë, me afat maturimi më të madh se një vit, të cilat emetohen dhe garantohen nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Karakteristikat e obligacioneve referencë përcaktohen në njoftimet respektive të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3. Zhvilluesi i Tregut është institucioni financiar, i cili është palë e marrëveshjes ndërmjet Zhvilluesit të Tregut (*Market Maker*) dhe MFE-së.

4. Komiteti i Zhvilluesve të Tregut (KZHT) është organi i themeluar nga MFE-ja dhe Zhvilluesit e Tregut.”.

Neni 3

Pas pikës 4, të nenit 3, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“5. Ministri përgjegjës për financat, në përputhje me nenin 20, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje dypalëshe me zhvilluesit e tregut, të përzgjedhur mbi bazën e shprehjes së interesit nga ana e tyre, për emetimin e obligacioneve referencë (*benchmark*) në tregun primar dhe kryerjen e transaksioneve me obligacionet referencë (*benchmark*) të Republikës së Shqipërisë, në tregun sekondar.”.



Neni 4

Pas nenit 9, shtohen nenet 9/1, 9/2 dhe 9/3, përkatësisht me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 9/1

Pjesëmarrja në ankandet e obligacioneve referencë (*benchmark*) nga zhvilluesit e tregut

1. Vetëm zhvilluesve të tregut u lejohet të marrin pjesë dhe të paraqesin kërkesa në ankandin për obligacionet referencë (*benchmark*).

2. Zhvilluesi i Tregut ka të drejtën ekskluzive të marrë pjesë në ankandet e blerjes mbrapsht dhe ankandet e shkëmbimit në lidhje me obligacionet referencë (*benchmark*).

3. Zhvilluesit e Tregut mund të vendosin kërkesa për llogari të tyre apo klientëve. Të gjithë ofertuesit e tjerë paraqiten nëpërmjet zhvilluesve të tregut. Nuk ka kufizime mbi numrin e kërkesave të paraqitura nga zhvilluesit e tregut.

4. Shuma maksimale e alokuar nga një zhvillues i tregut për llogari të vet nuk mund të jetë më e madhe se 40% e ofertës së shpallur.

5. Zhvilluesit e tregut janë të detyruar t'i paraqesin porositë e klientëve në ankand me një tarifë jo më të madhe se 0,7% e vlerës nominale të porosisë së klientit.

Neni 9/2

Mekanizmi i ofrimit

1. Ankandi i obligacioneve referencë (*benchmark*) zhvillohet si ankand me shumë çmime.

2. Obligacionet referencë (*benchmark*) do t'i ofrohen tregut nëpërmjet ankandëve me kërkesa konkurruese dhe jokonkurruese (oferta fillestare dhe rihapje) të organizuara nga MFE-ja nëpërmjet Bankës së Shqipërisë.

3. Ankandet e obligacioneve referencë do të zhvillohen sipas një plani vjetor të huamarrjes (kalendari i emetimeve të titujve qeveritarë). Në këtë kalendar, përcaktohet frekuenca e zhvillimit të ankandëve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të obligacioneve referencë (*benchmark*).

Neni 9/3

Rregullat e ankandit për obligacionet referencë (*benchmark*)

1. Shpallja e të dhënave të ankandit (ISIN, shuma) do të bëhet 1 javë kalendarike përpara

ankandit. Konfigurimi i të dhënave të ankandit në sistemin AFISaR do të jetë i hapur për marrjen e porosive dy ditë pune përpara ankandit.

2. Ankandi konkurrues zhvillohet nga ora 9:00 deri në orën 10:00. Orari i pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand përcaktohet në njoftimin e Ministrisë.

3. Gjatë procedurës së pranimit të kërkesave, MFE-ja mund të devijojë nga oferta e shpallur me maksimumin $\pm 15\%$. Devijimi duhet të mbështetet në cilësinë e kërkesave, jo në nivelet e *yield*-eve: pra *yield*-i maksimal i pranuar duhet të jetë kufiri i fundit në shpërndarjen normale të serisë së *yield*-eve të kërkuara.

4. Gjatë ankandit konkurrues mund të paraqiten edhe kërkesa jokonkurruese. Çdo zhvillues i tregut që merr pjesë në ankandin konkurrues ka të drejtë të blejë 50 milionë lekë me kërkesë jokonkurruese, duke përfutur *yield*-in mesatar të ponderuar të kërkesave të pranuar në ankand.”.

Neni 5

Pas pikës 3, të nenit 18, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Zotëruesve të obligacioneve referencë (*benchmark*) në momentin e pagesës së kuponit u mbahet tatimi mbi të ardhurat nga shuma e interesit efektiv të përfutur nga investimi. Në ankandet e rihapjes pjesëmarrësit taten mbi interesin efektiv dhe jo mbi atë nominal.”.

Neni 6

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 39, datë 1.6.2018****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME KONISPOL**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe të rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. 18 prot., të datës 6.3.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol është themeluar në datën 20.8.2017, si shoqëri aksionare me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Konispol, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 29.12.2018, me NUIS: L74829801V.

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol. Dosja u plotësua në datën 28.5.2018.

- Objekt i aktivitetit në ekstraktin e QKB-së është vetëm shërbimi i furnizimit me ujë dhe dokumentacioni mbi asetet e shoqërisë tregon se shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka në zotërim vetëm asetet e sistemeve të furnizimit me ujë edhe pse emrin shoqëria e ka ujësjiellës-kanalizime.

Faqe| 6098

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol plotëson të gjitha kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit mbi licencimin për herë të parë vetëm për shërbimin e furnizimit me ujë, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime Konispol sh.a., me:

Drejtues ligjor dhe drejtues teknik: Lefter Ballabani

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Konispol autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Konispol.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM**Nr. 40, datë 1.6.2018****PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË**

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar dhe



pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë për licencim për efekt të përfundimit të afatit, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 15, datë 13.6.2012, “Për rinovim licence Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë”, me vlefshmëri 4-vjeçare deri në datën 13.6.2016.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë, me anë të shkresës nr. 45 prot., të datës 18.5.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të përfundimit të afatit të licencës, shtim të kategorisë së largimit të ujërave të ndotura, si dhe zgjerim të zonës së shërbimit.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për përfundimin e afatit të licencimit, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Janë bërë ndryshimet përkatëse në ekstraktin e QKB-së mbi emrin e subjektit, zgjerimin e zonës së shërbimit dhe shtimin e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura;

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë, me:

Drejtues ligjor dhe drejtues teknik: z. Hysni Breçani

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është Bashkia Tropojë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 41, datë 1.6.2018

PËR LICENCIMIN E UJËSJIELLËS-KANALIZIME SHA FINIQ

Në zbatim të nenit 14, pika 1/“a”, të nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe të rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq për licencim për herë të parë, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për herë të parë, me shkresën me nr. prot. 245, të datës 23.4.2018, për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq është themeluar në datën 26.7.2017, si një shoqëri aksionare, me një nivel administrimi në pronësi të Bashkisë Finiq, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”. Kjo shoqëri është regjistruar në QKB në datën 31.7.2017, me NUIS: L76931502F.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq i shërben pjesërisht Bashkisë Finiq, pasi 9 (nëntë) fshatra furnizohen me ujë nga Ujësjiellës-



Kanalizime Sarandë sh.a., ku Bashkia Finiq zotëron 37.5% të kësaj shoqërie.

- Asambleja e përgjithshme e UK Sarandë, me vendimin nr. 1, datë 24.4.2017, ka vendosur fillimin e procedurave për zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë, me vlerën e aktiveve materiale (grupi i objekteve) që i transferohen Bashkisë Finiq.

- Në dosjen e aplikimit mungonte dokumenti i aktmiratimi higjieno-sanitar, ndërkohë që ishte sjellë vetëm raportanaliza e burimeve nga Drejtoria e Shëndetit Publik. Dosja u plotësua në datën 5.5.2018.

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Finiq sh.a. plotëson kërkesat e parashikuara në rregulloren e licencimit për licencim për herë të parë, konkretisht:

- Format i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- Për dokumentin “Ekstrakti historik i Regjistrat Tregtar”, në të cilin ende nuk janë reflektuar ndryshimet sipas riorganizimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq detyrohet të paraqesë pranë ERRU-së ekstraktin e QKB-së të përditësuar menjëherë pas përfundimit të procesit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq, me:

Drejtues ligjor: Niko Angjeli

Drejtues teknik: Foto Thanasi

2. Operatori Ujësjiellës-Kanalizime sh.a. Finiq autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zonat e shërbimit të këtij operatori janë njësitë administrative të Bashkisë Finiq, si më poshtë:

a) Finiq (përveç fshatit Vriion);

b) Aliko (përveç fshatrave Aliko, Çaus, Neohor, Tremul);

Faqe | 6100

c) Dhivër (përveç fshatit Navaricë);

d) Mesopotam (përveç fshatrave Livinë, Fitore, Krane, Ardhasovë);

e) Livadhja.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare (katërvjeçare).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 42, datë 13.6.2018

PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË UJËSJIJELLËS-KANALIZIME KAVAJË SHA

Në mbështetje të germës “h”, të pikës 1, të nenit 14, të nenit 15 dhe të nenit 32/1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe rregullores së inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 300 000 lekë, për ushtrimin e veprimtarisë pa licencë.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. dënohet me gjobë, në shumën 100 000 lekë, për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

KRYETARI
Ndriçim Shani

**VENDIM****Nr. 43, datë 13.6.2018****PËR MARRJEN E MASËS
ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË
UJËSJELLËS-KANALIZIME TROPOJË
SHA**

Në mbështetje të gurmës “h”, të pikës 1, të nenit 14, nenit 15 dhe nenit 32/1, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, dhe të rregullores së inspektimit të miratuar me vendim të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 58, datë 29.12.2017, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë sh.a. dënohet me gjobë në shumën 100 000 lekë për moszbatimin e vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 13.10.2004, “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik të sh.a. Ujësjiellës Tropojë”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë sh.a., për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet pranë Gjykatës Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni mbi vendimin.

**KRYETARI
Ndriçim Shani**

KËRKESË**Nr. 1690/5, datë 25.6.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim i sheshit të lagjes ‘Lugina’”, Bashkia Shijak.

Subjekti kërkues është Bashkia Shijak. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 1 828 200 (një milion e tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I BRENDSSHËM
Romina Kuko**



LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM I SHESHIT TE LAGJJA ‘LUGINA’”,
BASHKIA SHIJAK

Tabela me numër pasurie 6/298

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja truall/m ²	Çmimi/ lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Hysni Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Nafie Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Servete Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Zenepe Zija Koçiu	6/298	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						914 100	

Tabela me numër pasurie 6/299

Nr.	Emër, mbiemër	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sipërfaqja truall/m ²	Çmimi/ lekë/m ²	Vlera totale/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Abdyl Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Hysni Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Nafie Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Servete Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Zenepe Zija Koçiu	6/299	3369	60	3047	182 820	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
TOTALI						914 100	

Vlera e përgjithshme e dy pasurive nr. 6/298 dhe nr. 6/299 është 1 828 200 lekë.

**KËRKESË****Nr. 9145/1, datë 26.6.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Bashkia Krujë.

Me anë të këtij publikimi, kërkohet që të vihen në dijeni personat të cilët preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i rrugës hyrëse të qytetit, parkimi dhe rikualifikimi i qendrës së qytetit Krujë”, për shpronësimin e pasurive të tyre, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të

vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 37,208,922.52 (tridhjetë e shtatë milionë e dyqind e tetë mijë e nëntëqind e njëzet e dy pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “ZGJERIMI I RRUGËS HYRËSE TË QYTETIT, PARKIMI DHE RIKUALIFIKIMI I QENDRËS SË QYTETIT KRUJË”

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e truallit (m²)	Sip. e ndërtimit (m²)	Çmimi i truallit (l/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale	Shënime
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Artur Topçiu	8621	N 5/102+2	Krujë	—	50.16	—	—	2,605,902.79	2,605,902.79	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
2	Afrim Kaçi	8621	3/980	Krujë	—	12.25	—	—	829,516.83	829,516.83	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
3	Eduart Çela	8621	3/475	Krujë	329.30	154.2 banesë	4011	1,320,822.30	6,002,760.82 banesë	13,662,802.12	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt banimi dhe njësi shërbimi.
						175.1 shërbim			6,339,219 shërbim		
4	Enver Shuli	8621	3/1010	Krujë	305.80	36.1 banesë	4011	1,226,563.80	1694702.95 banesë	6,413,950.75	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt banimi dhe njësi shërbimi.
						80 shërbim			3492684 shërbim		
5	Fadil Qesja	8621	5/284	Krujë	—	42.67	—	—	2,115,430.11	2,115,430.11	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
6	Fatos Herri	8621	N 3/952	Krujë	17.00	17.00	4011	68,187.00	861,758.05	929,945.05	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi
7	Hektor Taga	8621	3/409-N2	Krujë	—	34.41	—	—	1,790,633.08	1,790,633.08	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
8	Ilirjan Taga	8621	3/409-N1	Krujë	—	34.41	—	—	1,984,142.88	1,984,142.88	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
9	Kujtim Vogli	8621	3/1175	Krujë	24.00	24.00	4011	96,264.00	1,507,914.96	1,604,178.96	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Njësi shërbimi.
10	Majlinda Pikli	8621	N 6/216	Krujë	—	45.00	—	—	2,093,679.90	2,093,679.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
11	Mehmet Emiri	8621	3/407-ND	Krujë	—	42.2 (1 kt.+p.)	—	—	2,022,239.19	2,022,239.19	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
12	Meleq Herri	8621	N 5/359	Krujë	—	37.00	—	—	1,156,500.86	1,156,500.86	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Krujë. Pasuri e llojit ndërtesë. Njësi shërbimi.
VLERA TOTALE										37,208,922.52	

**KËRKESË****Nr. 9148/1, datë 26.6.2018****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Devoll’”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Bashkia Gramsh.

Me anë të këtij publikimi kërkohet që të vihen në dijeni personat të cilët preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës ‘Devoll’”, për shpronësimin e pasurive të tyre, si dhe për masën e vlerësimit, të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138,

datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, si dhe të vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 3 717 507 (tre milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA PROJEKTI “REHABILITIMI I RRUGËS ‘DEVOLL’”

Nr.	Emër, mbiemër	Zona kadas-trale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e truallit (m ²)	Sip. e ndërtimit (m ²)	Çmimi i truallit (l/m ²)	Çmimi i ndërtimit (l/m ²)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera e ndërtimit sipas situacionit me TVSH (lekë)	Vlera e amortizimit (lekë)	Vlera e mbetur (lekë)	Totali	Konfirmim nga ZVRPP-ja
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
1	Fadile Meçollari	1842	7/249	Gramsh	36.20	20.15	2,472.00	—	89,486.00	726,948.00	139,574.00	587,374.00	676,860.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.
2	Dritan Konica	1842	7/330	Gramsh	100.20	61.80	2,472.00	—	247,694.00	1,710,503.00	136,840.00	1,573,663.00	1,821,357.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.
3	Ramadan Bici	1842	7/247	Gramsh	79.60	33.20	2,472.00	—	196,771.00	1,265,494.00	242,975.00	1,022,519.00	1,219,290.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Gramsh. Pasuri e llojit truall + ndërtesë. Objekt shërbimi.
													3,717,507.00	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë